



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.987/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik NULI, dhe zyrtaren ligjore Amire Jahiri, në kontestin tregtar-administrativ të paditësit “BI Term” SH.P.K me adresë në Fshatin Bibaj-Ferizaj, kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë duke vepruar sipas padisë së paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti – rivlerësim malli, vlerë kontesti e pa përcaktuar, jashtë seance, me datë 09.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET SE ËSHTË TËRHEQUR padia KF.nr.987/22 e datës 19.06.2022 e paditësit “BI Term” SH.P.K me adresë në Fshatin Bibaj-Ferizaj, për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore.

A R S Y E T I M

Paditësi “BI Term” SH.P.K, me adresë në Fshatin Bibaj-Ferizaj, me padinë e datës 19.06.2022 ka iniciuar në këtë Gjykatë kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, me bazë juridike: Anulim Vendimi nr.01.3.2.2/9502, 12392, 12342, 12865, 13912 të datës 06.07.2022 , objekt kontesti-rivlerësim malli.

Gjykata me datën 30.01.2023 , “BI Term” SH.P.K me adresë në Fshatin Bibaj-Ferizaj, ia ka dërguar vërejtjen për pagimin e taksës gjyqësore në padi në shumën prej 230.00 euro, me afat pagese prej 15 ditësh nga dita e pranimit, mirëpo edhe pas pranimit të kësaj vërejtje, pala paditëse nuk e ka paguar taksën gjyqësore në afatin ligjor (provë: fletë kthesën e pranuar nga paditësi “BI Term” SH.P.K me adresë në Fshatin Bibaj-Ferizaj, me datë 05.02.2023).

Në bazë të nenit 253 par. 4 të Ligjit nr. 03/L-006, për Procedurën Kontestimore (LPK-ë), i aplikuar përshtatshëmrisht sipas nenit 63 të LKA-së, ligji nr. 03/L-202, paditësi ka

për detyrë që padisë t'ia bashkëngjit edhe vërtetimin mbi taksën e paguar gjyqësore, ndërsa sipas paragrafit 5, të po këtij neni, nëse paditësi edhe pas vërejtjes së dërguar nga ana e Gjykatës nuk e paguan taksën gjyqësore, ndërsa nuk ekzistojnë kushtet për lirim e tij nga pagesa e taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.

Duke marrë për bazë faktin si më lartë se është konstatuar se paditësi edhe përkundër vërejtjes së Gjykatës të pranuar me datë 05.02.2023 sipas fletë kthesës nuk e ka paguar taksën gjyqësore për padi, dhe as nuk ka paraqitur kërkesë për lirim, Gjykata konsideron se janë plotësuar kushtet ligjore për ta konsideruar të tërhequr padinë e paditësit në këtë kontest tregtar-administrativ konform nenit 253, paragrafi 4 dhe 5 të LPK-së, Ligji nr. 03/L-006 i aplikuar përshtatshëm sipas nenit 63, të LKA-së, Ligji nr. 03/L-202, prandaj Gjykata nuk është lëshuar më tej në vendosje sipas padisë.

Duke marrë parasysh të lartcekurat, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim, nenit 253, paragrafi 4 dhe 5, të LPK-së i aplikuar përshtatshëm sipas nenit 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë / Departamenti Fiskal

KF.nr.987/2022, datë 09.01.2024

Zyrtare Ligjore

Amire JAHIRI

Gj y q t a r i

Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.